

V E N D I M

" PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIS SI PERSON JURIDIK "

Sot, më datë 23 X.1995 në Gjykatën e Rrethit Tiranë, unë Gjyqtarja e kësaj gjykate pasi u njoha me materjalin e paraqitur nga DRITAN DOKOLI dhe RENIS TËRSHANA për të regjistruar Shoqërin si person juridik :

K O N S T A T O V A

Se, Dritan Dokoli dhe Renis Tërshana kanë paraqitur kërkesën e tyre për të regjistruar shoqërinë si person juridik të themeluar prej tyre dhe të emëruar " R & T "shpk në aktivitetin e tregtar në tregtimin e artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor buqësor, konfeksione, mobilje, materjale ndërtimi e elektrik me shumicë e pakic Import - Export, me seli në Tiranë në Rrg. " Luigj Gurakuqi " Nr. 15, me një aktivitet mbi dhjetë vjet, me kapital 100.000lek i ndarë në mënyrë të barabartë midis tyre dhe me Administrator Dritan Dokolin. Kërkesa e tyre është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të Ligjës 7638 datë 19.XI.1992 " Për shoqëritë tregtare "

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik të Shoqërisë " R & T "shpk të themeluar nga ortakët DRITAN DOKOLI dhe RENIS TËRSHANA , në aktivitetin e tyre tregtar në tregtimin e artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, buqësor, konfeksione, mobilje, materjale ndërtimor dhe elektrik me shumicë e pakic Import Export. Kjo Shoqëri është me selin në Tiranë në Rrg. " LUIGJ GURAKUQI " Nr. 15 , me aktivitet mbi dhjetë vjet dhe me Administrator të vetëm Z.DRITAN DOKOLI.

Kun dra këtij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

Marije Rexhepi

V E N D I M

I gjyqtarit te vetem

Ne Tirane, sot me date 20 /12/1996, une gjyqtarja Florina Tegu, e Gjykates se Rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "R & T" shpk, Renis Tershana per depozitim prane regjistrimit tregtar te ndryshimeve te shoqerine "R & T" shpk, dhe

K O N S T A T O V A:

Se shoqeria "R & T" shpk e themeluar nga ortakët Dritan Dakoli dhe Renis Tershana, eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12540, dt. 23/10/1995, te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me daten 15/08/1996 ortakët Dritan Dakoli ne mbledhjen e asamblese se ortakëve ka kerkuar dhe kjo e fundit ka miratuar largimin e tij nga shoqeria dhe nga detyra e Administratorit te shoqerise. Per kete ortakët kane hartuar kontraten e shitjes se pjeseve te kapitalit te zoteruara nga ortakët Dritan Dakoli, te cilat jane blere teresisht nga ortakët Renis Tershana. Ne te njejten kohe Renis Tershana eshte emeruar edhe Administrator i Vetem i shoqerise "R & T" Sh.p.k.

Mbas ketyre ndryshimeve Shoqeria "R & T" Sh.p.k. rezulton me nje ortak dhe administrator te vetem Z. Renis Tershana, i biri i Agimit, lindur me 23.09.1971 ne Tirane, banues ne Tirane, rruga "Shyqyri Ishmi", Nr.17.

Kerkuesi kerkon depozitim ne aneksin e Regjistrimit Tregtar, te proces verbalit te vendimeve te mesiperme te Asamblese se Ortakëve, kontraten e shitjes se pjeseve te kapitalit dhe regjistrimin e ndryshimeve perkatese te statutit te shoqerise "R & T" Sh.p.k.

Kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993

V E N D O S A:

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitim ne regjistrimin tregtar te proces-verbalit date 15/08/1996 te Asamblese se Ortakëve te shoqerise "R & T" Sh.p.k. dhe kontrates se shitjes se pjeseve te kapitalit.
- Urdherimin e zyres se regjistrimit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kolonen nr. 4 dhe 5.
- Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri tjetri me nr. rendor 2.

20. 12. 1996

GJYQTARE
/ Florina Tegu /
[Signature]

VENDIM

I gjyqtarit te vetem

Ne Tirane, sot me date 13/06/1997, une gjyqtarja Gjergj Bishri, e Gjykates se Rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "R & T" shpk, Renis Tershana per depozitim prane regjistrit tregtar te ndryshimeve te shoqerine "R & T" shpk, dhe

KONSTATOVA:

Se shoqeria "R & T" shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12540, dt. 23/10/1995, te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me daten 20/05/1997 ortakut i vetem Renis Tershana ka vendosur qe ne objektin e veprimtarise se shoqerise te shtoje edhe aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit me shumice e pakice te bojrave hidromate dhe lendeve larese (detergjenteve)".

Kerkuesi kerkon depozitim ne aneksin e Regjistrit Tregtar, te vendimit te Ortakut te Vetem date 20.05.1997 dhe regjistrimin e ndryshimeve perkatese te statutit te shoqerise "R & T" Sh.p.k.

Kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitim ne regjistrin tregtar te Vendimit te Ortakut te Vetem date 20/05/1997 Ortakut te Vetem te shoqerise "R & T" Sh.p.k.
- Urdherimin e zyres se regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kolonen nr. 4 dhe 5.
- Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri tjetri me nr. rendor 2.

GJYQTARE

Gjergj Bishri
13/06/1997

V E N D I M

I gjyqtarit te vetem

Ne Tirane, sot me date 6/2/1999, une gjyqtarja A. Xhepa e Gjykates se Rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori i vetem i shoqerise "R & T" shpk, Renis Tershana per depozitimin prane regjistrin tregtar te ndryshimeve te shoqerine "R & T" shpk, dhe

K O N S T A T O V A:

Se shoqeria "R & T" shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12540, dt. 23/10/1995, te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me daten 20/02/1999 ortaku i vetem Renis Tershana ka vendosur qe ne objektin e veprimtarise se shoqerise te shtoje edhe aktivitetin e kembimeve valutore.

Kerkuesi kerkon depozitimin ne aneksin e Regjistrin Tregtar, te vendimit te Ortakut te Vetem date 20.02.1999 dhe regjistrimin e ndryshimeve perkatese te statutit te shoqerise "R & T" Sh.p.k.

Kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar.

P E R K E T O A R E S Y E

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993

V E N D O S A:

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin ne regjistrin tregtar te Vendimit te Ortakut te Vetem date 20/02/1999 Ortakut te Vetem te shoqerise "R & T" Sh.p.k.
- Urdherimin e zyres se regjistrin tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kolonen nr. 4 dhe 5.
- Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri tjetri me nr. rendor 2.

GJYQTARE

A. Xhepa
Chor

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. 12540/4
481

V E N D I M

I gjyqtarit te vetem

Ne Tirane ,sot me date 13. 10 .1999,une gjyqtari A. Cepo i/e Gjykates se Rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Renis Tershana administrator I vetem I shoqerise "R&T"sh.pk, per depozitimin prane regjistrin tregtar Te ndryshimeve te bera ne kete shoqeri dhe

K O N S T A T O V A :

Se shoqeria "R&T" sh.p.k eshte regjisrtuar si person juridik me vendimin 12540 date 23.10.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane ,me te cilin vertetohet se perfundimisht ortak i vetem i shoqerise "R&T"sh.p.k Renis Tershana.

Me date 06.10.1999 Ortaku i Vetem Renis Tershana ka vendosur te shtoje kapitalin e shoqerise me shumen 2500000 (dymilione peseqindmije) leke perfundimisht kapitali I shoqerise R&T nga 100000 (njeqindmije) leke behet 2.600.000 (dymilione gjashteqindmije)leke.

Kerkuesi kerkon depozitimin ne aneksin e Regjistrin Tregtar te ndryshimeve te bera ne statutin e shoqerise "R&T",me vendimin perkates te Ortakut te Vetem te saj.

Kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr.7667 dt.28.01.1993

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses

Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit te Ortakut te Vetem, date 06.10.1999 Urdherimin e zyres se regjistrimit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kolonen nr. dhe ndryshime te cilat konsistojne ne shtimin e kapitalit te shoqerise ne masen 2500000 (dymilione peseqindmije)leke

Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri tjetri me nr. rendor

GJYQTAR

Avila Cepo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 12540/1 Rep.

VENDIM I GJYGJTARIT TE VETEM

Sot ne daten 20. 05.2000,une Gjygtare 14 Dophe, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Renis Tershana me objekt,depozitimin e akteve per ndryshimet ne akt Themelimin dhe Statutin e Shoqerise "R&T" SHPK dhe,

K O N S T A T O V A

Me Vendimin e Gjykates me numer 12540 date 23.11.1995, Shoqeria "R&T" SHPK eshte rregjistruar si person juridik me Objektin e percaktuar ne vendimin e Gjykates.

Ne daten 22.05.2000,u be mbledhja e Asamblese se Ortakeve me kete rend dite,

1.Shtim objekti te Shoqerise "R&T" SHPK ne fushen e kryerje te servisit te aparaturave dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike si dhe kompletimin e tyre.

2.Pas nenit 7 te aktit te themelimit dhe statutit shtohet neni 7/1 me kete permbajtje "pas shtimit te objektit te shoqerise R&T SHPK ne fushen e aparaturave dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike si dhe kompletimin e tyre te hape dege te shoqerise,(si pjese perberese e saj)te emertuar "Data Servise"

Kerkesa per depozitimin akteve per ndryshimet
PER KETO ARESYE

Mbeshtetur ne Ligjin 7667 date 28.01.1993

V E N D O S A

Depozitimin e Kerkeses,dhe Vendimit te Ortakut te Vetem ne Rregjistrin Tregtar me keto ndryshime..

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat perkatese te Rregjistrin Tregtar.

1.Shtim objekti te Shoqerise "R&T" SHPK ne fushen e kryerje te servisit te aparaturave dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike si dhe kompletimin e tyre.

2.Pas nenit 7 te aktit te themelimit dhe statutit shtohet neni 7/1 me kete permbajtje "pas shtimit te objektit te shoqerise R&T SHPK ne fushen

e aparaturave dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike si dhe kompletimin e tyre te hape dege te shoqerise,(si pjese perberese e saj)te emertuar “Data Servise”

Te behet ndarja me vize te kuqe te ndryshimeve te bera.

Kunder ketij vendimi behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYGJTARE

Majlinda Dajç
Dajç

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 12540/05 Vend.

**V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M**

Ne Tirane, sot me date 5. / 10. / 2000, une Gjyqtarja
E. Rado e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen
e paraqitur nga **Renis TERSHANA**, per depozitimin prane regjistrit
tregetar te ndryshimeve te bera ne Shoqerine " R & T " Shpk dhe .

K O N S T A T O V A

Me vendimin e Gjykates me numur 12540 date 23.11.1995,
Shoqeria " R & T " Shpk eshte regjistruar si person juridik me objektin e
percaktuar ne Vendimin e Gjykates.

Me daten 22.09.2000 u be mbledhja e Vendimit te Ortakut te
vetem me kete rend dite :

Shtimin e objektit te shoqerise " R & T " Shpk " ne fushen e
**studimit, projektimit, ndertimit si dhe te shfrytezimit te paisjeve dhe
rrjeteve te telekomunikacioneve ne funksionin e Operatorit te
Telekomunikacioneve per Publikun.**

Pasi shqyrtova kerkesen e Shoqerise " R & T " Shpk e gjykoj ate
te drejte dhe si e tille duhe te pranohet .

P E R K E T O A R S Y E

Bazuar ne Ligjin Nr; 7638 date 10.11.1992 " Per Shoqerite
Tregetare " dhe ne nenin 33 te Ligjit Nr. 7667 date 29.01.1993 " Per
regjistrin tregetar"

V E N D O S A :

Depozitimin e kerkeses dhe te Vendimit te Ortakut te Vetem ne
Regjistrin Tregetar dhe ndryshimet perkatese ne kollonat perkatese te
Regjistrimit Tregetar.

Shtimin e objektit te Shoqerise “ R & T “ Shpk” ne fushen e studimit,projektimit,ndertimit si dhe te shfrytezimit te paisjeve dhe rrjeteve te telekomunikacioneve ne funksionin e Operatorit te Telekomunikacioneve per Publikun”.

Te behet ndarja me viza te kuqe per ndryshimet e bera.

Kunder ketij vendimi behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

G J Y Q T A R I

Endeja Bay
Maylis

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. *1264/06* Vendimit

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten *06-12-00*, une gjyqtari *M Deda* gjykates se rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e tjera te paraqitura nga Z. Renis TERSHANA, administrator i shoqerise "R & T" sh.p.k. me seli ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit" Nr. 4 , Tirane., per depozitimim e tyre ne regjistrin tregetar, ne baze te ligjit 7667 date 28.1.1993 dhe ,

K O N S T A T O V A

Se kerkesa e bere nga Z. Renis TERSHANA, administrator i shoqerise "R & T" sh.p.k., person juridik i regjistruar me vendimin e kesaj gjykate me Nr.12540 date 23.10.1995, per depozitimim ne regjistrin tregetar te vendimit te ortakut te vetem te Shoqerise "R & T" sh.p.k., te dates 23.11.2000, ne te cilin eshte vendosur: Ortaku i vetem, Z. Renis TERSHANA ti shese Z. Ervin Lera, i biri i Nasit dhe i Olimbise, lindur ne Tirane, me 02.04.1973, banues ne rrugen "F.Xhajko" , P.67\1, shk. 5, ap. 50, Tirane, 50 (pesedhjet) perqint te kapitalit themeltar te shoqerise, ne shumen 1.300.000 (njemilion e treqint mije) leke. Me ndryshimet e bera rezulton se ortakte te kesaj shoqerie jane Renis TERSHANA dhe Ervin Lera te cilet zoterojne, ne pjese te barabarta, nga 50 perqint te kapitalit themeltar te shoqerise, eshte e drejte dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

ne baze te ligjit 7667 date 28.1.1993

V E N D O S A

Te pranoj kerkesen per depozitimim ne regjistrin tregetar te vendimit te Oratkut te vetem te shoqerise "R & T" sh.p.k. te dates 23.11.2000 ne te cilin eshte vendosur: Ortaku i vetem, i shoqerise "R & T" sh.p.k., Z. Renis TERSHANA, ti shese Z. Ervin Lera, 50 perqint te kapitalit themeltar te shoqerise, ne shumen 1.300.000 (njemilion e treqint mije) leke. Me ndryshimet e bera, ortakte te shoqerise "R & T" sh.p.k. jane Renis TERSHANA dhe Ervin Lera te

cilet zoterojne, ne pjese te barabarta, nga 50 perqint te kapitalit themeltar te shoqerise.

Te depozitohet dokumentacioni perkates. Urdheroj Zyren e regjistrit tregetar , ne Gjykatën e rrethit Tirane, qe ne baze te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise "R & T" sh.p.k., te dates 23.11.2000, te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQATRI

Manana Jex
Debesij

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. *12540/2* Rep.

VENDIM I GJYGJTARIT TE VETEM

Sot ne daten *19/03.2002*,une Gjygtare *A. Kuqoshi*, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Renis Tershana me objekt,depozitimin e Kerkeses dhe te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "R&T" SHPK me Ortak Z.Renis Tershana dhe,

K O N S T A T O V A

Me Vendimin e Gjykates me numer 12540 date 23.10.1995, Shoqeria "R&T" SHPK eshte rregjistruar si person juridik me Objektin e percaktuar ne aktin e Themelimit dhe te Statutit te shoqerise.

Ne daten 19.03.2002,u be mbledhja e Asamblese se Ortakeve me kete rend dite,

1.Largimin nga shoqeria te Ortakut Ervin Lera.

2.Transferimin e 50% te kuotave te Z.Ervin Lera tek Ortaku Renis Tershana.

Ne Shoqeri mbetet Ortak i Vetem Z.Renis Tershana me 100% te kuotave.

PER KETO ARESYE

Mbeshtetur ne Ligjin 7667 date 28.01.1993

V E N D O S A

Depozitimin e Kerkeses,dhe Vendimit te Asamblese se Ortakeve ne Rregjistrin Tregtar me keto ndryshime.

1.Largimin nga shoqeria te Ortakut Ervin Lera.

2.Transferimin e 50% te kuotave te Z.Ervin Lera tek Ortaku Renis Tershana.

Ne Shoqeri mbetet Ortak i Vetem Z.Renis Tershana me 100% te kuotave.

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat perkatese te Rregjistrin Tregtar.

Te behet ndarja me vize te kuqe te ndryshimeve te bera.

Kunder ketij vendimi behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYGJTARE

A. Kuqoshi
G.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES PARE

Nr. 12540/Vendimit.

V E N D I M
I
GJYGJTARIT TE VETEM

Sot ne daten 05.2003,une Gjygtare B. Kucere, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Renis Tershana Administrator te Shoqerise "R&T" SHPK me objekt,depozitimin e Kerkeses dhe Vendimit te Ortakut te vetem "R&T" SHPK dhe,

K O N S T A T O V A

Me Vendimin e Gjykates me numer 12540 date 23.10.1995 Shoqeria "R&T" SHPK eshte regjistruar si person juridik me Objektin e percaktuar ne aktin e Themelimit dhe te Statutit te shoqerise .ne fushen e :

Objekti i veprimtarise se kesaj Shoqerise eshte ne fushen e :tregtimit te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, bujqesore, konfeksione, mobilje, materiale ndertimi , elektrike, me shumice dhe me pakice ne import eksport.Kembim valutor,ne fushen e studimit, projektimit, ndertimit dhe shfrytezimit te pajisjeve dhe rrjeteve ne fushen e telekomunikacioneve, ne funksionin e operatorit te telekomunikacionit per publikun,ne fushen e kryerjes te servisit, te apartaurave te pajisjeve elektrike dhe ekonomike dhe kompletimin e tyre,prodhimin dhe tregtimin me shumice dhe me pakice te bojrave hidromate dhe lendeve larese, detergjente.

Ne mbledhjen e Ortakut te Vetem u vendos:Shtim te aktivitetit te Shoqerise edhe ne fushen e:

Prodhime te materialeve te ndertimit te te gjitha llojeve,

Ndertime civile dhe ekonomike si industriale,turistike, bujqesore tj,

Ndertime rrugore te kategorise se pare, dyte, trete, te katert dhe te peste, mirembajtje dhe ndertim autostradash,pista ,aeroporte.

Ndertime hekurudhore, punime te shinave dhe te traseve.

Ndertime ura dhe vepra arti,tunele rrugore dhe hekurudhore.

Ndertime detare, portuale, bankina, drenime.

Ndertime hidraulike dhe hidroteknike.

Vepra te vecanta dhe punime speciale.

Punime dhe restaurime si monumente kulture, arkeologjike etj.

Punime karpentiere druri dhe metali.

Impiante teknologjike dhe te vecanta.

Punime , montime ne impiantet e prodhimit dhe te shperndarjes se energjise.

Punime sherbimi ne siperfaqe gjelberimi ne parqe, pyje, pastrim siperfaqe urbane,mirembajtje dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane, ndricim,sinjalizim, urban.

Punime topogjeodezike, rivelimetopografike,punime topogjezike ,punime speciale gjeodezike.

Punime elektrike, mekanike,kondicionimi,ventilimi.

PER KETO ARESYE

Mbeshtetur ne Ligjin 7667 date 28.01.1993

V E N D O S A

Depozitimin e Kerkeses,Vendimit te Ortakut te Vetem te Shoqerise”R&T”SHPK me keto ndryshime.

Shtim te aktivitetit te Shoqerise edhe ne fushen e:

Prodhime te materialeve te ndertimit te te gjitha llojeve,

Ndertime civile dhe ekonomike si industriale,turistike, bujqesore tj,

Ndertime rrugore te kategorise se pare, dyte, trete, te katert dhe te peste, mirembajtje dhe ndertim autostradash,pista ,aeroporte.

Ndertime hekurudhore, punime te shinave dhe te traseve.

Ndertime ura dhe vepra arti,tunele rrugore dhe hekurudhore.

Ndertime detare, portuale, bankina, drenime.

Ndertime hidraulike dhe hidroteknike.

Vepra te vecanta dhe punime speciale.

Punime dhe restaurime si monumente kulture, arkeologjike etj.

Punime karpentiere druri dhe metali.

Impiante teknologjike dhe te vecanta.

Punime , montime ne impiantet e prodhimit dhe te shperndarjes se energjise.

Punime sherbimi ne siperfaqe gjelberimi ne parqe, pyje, pastrim siperfaqe urbane,mirembajtje dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane, ndricim,sinjalizim, urban.


Punime topogjeodezike, rivelimetopografike,punime topogjezike ,punime speciale gjeodezike.

Punime elektrike, mekanike,kondicionimi,ventilimi.

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat perkatese te Rregjistrimit Tregtar.

Te behet ndarja me vize te kuqe te ndryshimeve te bera.

Kunder ketij vendimi behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYKOTARE


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 12540/9 VENDIMIT

V E N D I M

“PER NDRYSHIMIN E STATUTIT TE SHOQERISE”

Sot, me date 14/01/09 ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane, une Gjyqtari
A. Qerri i kesaj Gjykate pasi u njoha me materialin e paraqitur nga Z. RENIS
TERSHANA, Administrator i shoqerise R&T Sh.p.k., per te depozituar ndryshimet
perkatese ne statutin e shoqerise:

KONSTATOVA SE:

Ne Mbledhjen e Asamblese te mbajtur ne daten 19/11/2003 te shoqerise R&T Sh.p.k., me
Ortak te Vetem Z. Renis Tershana, te regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane
me Vendim Nr.12540, date 23/10/1995, u vendos si me poshte vijon:

Ndryshimi i statutit te Shoqerise “R&T” Sh.p.k., Neni 4 “Objekti i Veprimtarise” me
shitesat dhe ndryshimet perkatese.

Objekti i veprimtarise se kesaj Shoqerie eshte ne fushen e tregtimit te artikujve te
ndryshem industriale, ushqimore, bujqesore, konfeksione, mobilje, materiale ndertimi,
elektrike, me shumice dhe me pakice ne import-eksport.

Kembim valutor ne fushen e studimit, projektimit, ndertimit, dhe shfrytezimit te pajisjeve
edhe rrjeteve ne fushen e telekomunikacioneve, ne funksionin e operatorit te
telekomunikacionit per publikun, ne fushen e kryerjes se servisit, te aparaturave te
paisjeve elektrike dhe ekonomike dhe kompletimin e tyre, prodhimin dhe tregtimin me
shumice dhe me pakice te bojrave hidromate dhe lendeve larese dhe detergjente.

Prodhime te materialeve te ndertimit te te gjitha llojeve, ndertime civile dhe ekonomike si
industriale, turistike, bujqesore etj.

Ndertime rrugore te kategorise se pare, se dyte, se trete, se katert dhe te peste,
mirembajtje dhe ndertim autostradash, pistash dhe aeroporte.

Ndertime hekurudhore, punime te shinave, traseve. Ndertime ura dhe vepra arti, tunele
rrugore dhe hekurudhore. Ndertime detare, portuale, bankina, drenime.

Ndertime hidraulike dhe hidroteknike. Vepra te vecanta dhe punime speciale.

Punime dhe restaurime si monumente kulture, arkeologjike etj. Impiante teknologjike dhe
te vecanta.

Punime, montime ne impiantet e prodhimit dhe te shperndarjes e energjise.

Punime sherbimi ne siperfaqe gjelberimi, ne parqe, pyje, pastrim siperfaqe urbane,
ndricim, sinjalizim urban.

Punime topogjeodezike, rivlime topografike, punime topogjezike, punime speciale gjeodezike. Punime elektrike, mekanike, kondicionimi, ventilimi.

Mbledhja e Asamblese me Ortak te Vetem Z. Reniz Tershana vendosi shtimin e aktivitetit te shoqerise ne fushen e:

- o Tregtimit, instalimit dhe sherbimit te makinerive dhe paisjeve elektronike, kompjuterike dhe informatike.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses se Z. RENIS TERSHANA per te depozituar ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise si me poshte vijon:


Shtimin e aktivitetit te shoqerise ne fushen e:

- o Tregtimit, instalimit dhe sherbimit te makinerive dhe paisjeve elektronike, kompjuterike dhe informatike.

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat respektive te Regjistrit Tregtar.

Kunder ketij vendimi behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE



Merina Kufeshe

V E N D I M

“PER NDRYSHIMIN E STATUTIT TE SHOQERISE”

Sot, me date 10/09/09 ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane, une Gjyqtari [Signature] i kesaj Gjykate pasi u njoha me materialin e paraqitur nga Z. RENIS TERSHANA per te depozituar ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise:

KONSTATOVA SE:

Ne Mbledhjen e Asamblese te mbajtur ne 06/09/2004 te shoqerise “R & T” Sh.p.k., te regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me Vendim Nr.12540, date 23/10/1995, me Ortak te Vetem Renis Tershana u vendos si me poshte vijon:

Ndryshimi i statutit te Shoqerise “R&T” Sh.p.k., Neni 4 “Objekti i Veprimtarise” me shitesat dhe ndryshimet perkatese, duke shtuar objektin e veprimtarise si me poshte:

Studime dhe konsulence ne fushen e shendetsise.

Te pasqyrohen ndryshimet perkatese ne nenin 4 te Statutit te shoqerise.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 “Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.

V E N D O S A

1. Pranimin e kerkeses se Z. RENIS TERSHANA per te depozituar ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise si me poshte vijon:

Shtimi i aktivitetit te shoqerise me studime dhe konsulence ne fushen e shendetsise.

2. Depozitimim ne Regjistrin Tregtar te Vendimit te Ortakut te Vetem date 04 Shtator 2004 te shoqerise “R & T” Sh.p.k.
3. Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet ne kolonen perkatese.

4. Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri-tjetri.

Kundra ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTAR

Blendi Beqiri
Beqiri

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
VENDIMI Nr. 12540/11

VENDIMI I GJYQTARIT TE VETEM
-Per depozitimin e akteve te personit juridik-

Sot, me date 17 / 1 / 2005 (dymijepese), une M. Dajpa, Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria "R & T ,, sh.p.k. perfaqesuar nga Administratori i saj Renis Tershana per depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit te asamblese se ortakve per zmadhimin e kapitalit, se bashku me dokumentat perkatese ,nga te cilet:

KONSTATOVA

Se, shoqeria "R & T ,, sh.p.k. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar sipas te drejtes shqiptare, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendim nr. 12540 date 23.10.1995 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Se, Asambleja e ortakut te vetem ne mbledhjen e mbajtur me date 06.01.2005 me **unanimitet ka vendosur:**

1. Te zmadhoje kapitalin e shoqerise "R & T ,, sh.p.k. nepermjet emetimit te pjesve te reja te kapitalit themeltar me vlere nominale te njejte me ato te meparshme. Zmadhimi do te kryhet duke kompensuar:
a- fitimin e paterhequr nga ortaku i vetem deri me 31.12.2004.

2. Te emeroje Z.Nexhip Sulejman ÇEÇI, ekspert kontabel i autorizuar, mbajtes i licenses Nr.61 leshuar me 10.02.2000 nga IEKA., te kryeje aktin e ekspertimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise.

3. Te gjitha veprimet e nevojshme ne Gjykate do te kryhen nga Ortaku i vetem i shoqerise zoti Renis Tershana, duke hartuar dhe nenshkruar cdo dokument te nevojshem, per depozitimin e akteve dhe regjistrimet perkatese prane Regjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr.7638, date 19,11,1992, "Per shoqerite tregtare,, dhe te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993, "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",

V E N D O S A:

- (i) Pranimin e kerkeses.
- (ii) Depozitimin ne regjistrin tregtar te **vendimit** te Asamblese se Ortakut te vetem te shoqerise **"R & T ,, sh.p.k. , Nr.1 date 06.01.2005** ,si dhe regjistrimin e ndryshimeve ne kollonat perkatese te regjistrit tregtar.
- (iii) Depozitimin ne regjistrin tregtar te **procesverbalit** te Asamblese se Ortakut te vetem te shoqerise **"R & T ,, sh.p.k. , Nr.1 date 06.01.2005** ,si dhe regjistrimin e ndryshimeve ne kollonat perkatese te regjistrit tregtar.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen _____,germa _____,si dhe te behet ndarja nga njeri tjetri me vize te kuqe.

GJYOTARE
Mirajuzda Dega
Dega

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
VENDIMI Nr. 12540/12

VENDIMI I GJYQTARIT TE VETEM
-Per depozitimimin e akteve te personit juridik-

Sot, me date 12 10 2005 (dymijepese), une M. Kullaj
Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim
kerkesen e paraqitur nga shoqeria "R & T ,, sh.p.k. perfaqesuar nga
Administratori i saj Renis Tershana per depozitimimin ne regjistrin tregtar te
vendimit te asamblese se jashtezakonshme te ortakut te vetem per
zmadhimin e kapitalit, se bashku me dokumentat perkatese , nga te cilet:

KONSTATOVA

Se, shoqeria "R & T ,, sh.p.k. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e
themeluar sipas te drejtes shqiptare, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me
vendim nr. **12540** date **23.10.1995** te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Se, Asambleja Jashtezakonshme e ortakut te vetem ne mbledhjen e mbajtur
me date **05. 04 . 2005** me ka vendosur:

1. Miratimin e aktit te ekspertimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise,
date **01.04.2005** te Ekspertit Nexhip Sulejman ÇEÇI, ekspert kontabel i
autorizuar, mbajtes i licenses Nr.61 leshuar me 10,02,2000 nga IEKA.

2. Te zmadhoje kapitalin e shoqerise "R & T,, sh.p.k. nga shuma
2.600.000 leke ne shumen **66.100.000** (gjashtedhjeteeegjashtemilioneqind
mije) leke nepermjet emetimit te **63.500** pjeseve te reja.

Pas ketij zmadhimi,

Ortaku, **Z. Renis Tershana** nenshkruan **63.500** pjese te reja me vlere
63.500.000 (gjashtedhjetetremilioneqindmije) leke dhe per kete
shume i paksohet e drejta per terheqjen e fitimit per tu shperndare dhe te
paterhequr per **63.500.000** (gjashtedhjetetremilioneqindmije) leke .

3. Te kompenesojë fitimin për të shpërndarë dhe të paterhequr që ortakut i vetëm ka ndaj shoqërisë, si shlyerje të kontributit në para për nënshkrimin e pjesëve të reja. Pjesët e reja nënshkruhen dhe shlyhen plotësisht.

4. Ndryshimin e tekstit të **nenit 5** të statutit të shoqërisë si pasojë e zmadhimit të kapitalit, si më poshtë vijon:

“Kapitali themeltar i shoqërisë është **66.100.000** leke. Ky kapital ndahet në pjesë të barabarta, vlera nominale e të cilave është **1000** leke.

Ai është i ndarë në **66.100** pjesë, plotësisht të shlyera, të renditura sipas numurit të serisë nga një në **66.100**. Kapitali themeltar përbehet nga kontributet e **Ortakut të Vetëm Z. Renis Tershana, i cili** kontribuon me shumën **66.100.000** leke ose **100 %**.”

5. Për të kryer veprimet në Gjykatë autorizohet **Ortakut i Vetëm** dhe Administratori i Shoqërisë, **zoti Renis Tershana**, duke hartuar dhe nënshkruar çdo dokument të nevojshëm, për depozitimin e akteve dhe regjistrimet përkatëse pranë Regjistrat Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

PER KETO ARSYE

Në bazë të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, ”Për shoqëritë tregtare,, dhe të Ligjit nr.7667, datë 28.01.1993, ”Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”,

V E N D O S A:


(i) Pranimin e kërkesës.


(ii) Depozitimin në regjistrin tregtar të **vendimit** të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakut të vetëm të shoqërisë **“R & T ,, sh.p.k. , Nr.2** datë **05.04.2005** dhe regjistrimin e ndryshimeve në kollonat përkatëse të regjistrat tregtar.

(iii) Depozitimin ne regjistrin tregtar te **procesverbalit** te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te vetem te shoqerise "R & T ,, sh.p.k. , Nr.2 date **05.04.2005** dhe regjistrimin e ndryshimeve ne kollonat perkatese te regjistrit tregtar.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen _____,germa _____,si dhe te behet ndarja nga njeri tjetri me vize te kuqe.

GJYQTARE





REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 12540/13 VENDIMIT

V E N D I M

“PER NDRYSHIMIN E STATUTIT TE SHOQERISE”

Sot, me date 13/10/05 ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane, une Gjyqtari A. C. C. C. i kesaj Gjykate pasi u njoha me materialin e paraqitur nga Z. RENIS TERSHANA per te depozituar ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise:

KONSTATOVA SE:

Ne Mbledhjen e Asamblese te mbajtur ne _____ te shoqerise “R & T” Sh.p.k., te regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me Vendim Nr.12540, date 23/10/1995, me Ortak te Vetem Renis Tershana u vendos si me poshte vijon:

Ndryshimi i statutit te Shoqerise “R&T” Sh.p.k., Neni 15 “Emerimi i Administratorit” me shtesat dhe ndryshimet perkatese.

Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume persona fizike qe mund te zgjidhen brenda ose jashte shoqerise.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ose statuti ia jep shprehimisht Ortakeve, si dhe te kryeje blerje e shitje ne nje shume te palimituar.

Veprimtaria e perditshme e shoqerise drejtohet nga administratori, i cili per realizimin e qellimeve te shoqerise ka te drejte t’a perfaqesoje ate dhe ne emer te saj te paraqitet para te gjitha organeve e institucioneve shtetore apo private, te lidhe kontrata si dhe te paraqitet perpara gjykatave te te gjitha shkalleve per mbrojtjen e interesave te shoqerise.

Gjithashtu ka te drejte qe me prokure te posacme te autorizojë dhe jape tagrat e nevojshme personave te ndryshem te specializuar ne fusha te ndryshme, gjithmone per mbrojtjen e interesave te shoqerise, per te kryer nje ose disa nga veprimet e lartpermendura.

Te pasqyrohen ndryshimet perkatese ne nenin 15 te Statutit te shoqerise.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

VENDOSA

1. Pranimin e kerkeses se Z. RENIS TERSHANA per te depozituar ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise si me poshte vijon:

Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume persona fizike qe mund te zgjidhen brenda ose jashte shoqerise.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ose statuti ia jep shprehimisht Ortakeve, si dhe te kryeje blerje e shitje ne nje shume te palimituar.

Veprimtaria e perditshme e shoqerise drejtohet nga administratori, i cili per realizimin e qellimeve te shoqerise ka te drejte t'a perfaqesoje ate dhe ne emer te saj te paraqitet para te gjitha organeve e institucioneve shteterore apo private, te lidhe kontrata si dhe te paraqitet perpara gjykatave te te gjitha shkalleve per mbrojtjen e interesave te shoqerise.

Gjithashtu ka te drejte qe me prokure te posacme te autorizojte dhe jape tagrat e nevojshme personave te ndryshem te specializuar ne fusha te ndryshme, gjithmone per mbrojtjen e interesave te shoqerise, per te kryer nje ose disa nga veprimet e lartpermendura.

2. Depozitimim ne Regjistrin Tregtar te Vendimit te Ortakut te Vetem date _____ 200__ te shoqerise "R & T" Sh.p.k.
3. Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet ne kolonen perkatese.
4. Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri-tjetri.

Kundra ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQATAR

Ana me Coco
14

Çirakutë regjistrimi

12540

1
2 a- "R & T" Shtet.

b. Ri: D. Guroshipi; Nr 15. "Çirakutë"

c- Bregthim; arritje të 7 industrial
urapimor, bujqesor, konfektioner, mobilje
materiale, ndërtimor. Është shpërndarë me
shumicë e politikë; import eksport.

d. 100000 lekë

1- Rendi Bashkës 50%

2- Dritan Dokoli 50%

3. Adm. i vetëm. Dritan Dokoli

dat. 1967. Banes. Ri. Bete Bashkës.

p. 122/1/14.

4. 15 vjet
M. 2 fletë
S. 5 fletë

5. e d 3 - 10 - 95

e - 23 - 10 - 95

[Signature]

MA: 208836.

dat 20-Tetor 1967.

D. Murdime Çirakutë



STATUTI I SHOQËRISE

KREU I

EMËRTIMI, SELIA, KOHË ZGJATJA DHE AKTIVITETI

NENI 1

Shoqëria emërtohet " R & T " sh.p.k. IMPORT EXPORT.

Ajo është person juridik dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me aktin e themelimit (kontratën) në këtë statut dhe gjithmonë në zbatim të legjislacionit shqiptar.

NENI 2

Shoqëria ka selinë e saj në TIRANË, në Rrg. " LUIGJ GURAKUQI Nr. 15 dhe me të drejtë për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

NENI 3

Kohë zgjatja e aktivitetit të shoqërisë është mbi dhjetë vjet.

NENI 4

Shoqëria ka për ob jekt të saj:

- Tregtimin e artikujve të ndryshëm, industrial, ushqimor, bujqësor, konfeksione, kinkalerina, mobilje, materjale ndërtimor elektrik me shumicë e pakic Import Export.

Si dhe çdo aktivitet tjetër që veças ose sëbashku me ato të përmendura më sipër do të konsiderohen të përshtatshme dhe me leverdi për rritjen e zhvillimin e shoqërisë.

KAPITALI THEMELOR

KREU II

NENI 5

NENI 5

Kapitali themelor i shoqërisë është 100.000 lek i ndarë në mënyrë të barabartë në kuotat 50% dhe 50% se jollë dhe merret përsipër dhe nënshkruhet si më poshtë:

1. DRITAN DODLI 50%
2. ROHIS TËRSHANA 50%

NENI 6

Kuotat e kapitalit mund të shiten midis ortakve sipas vlerës së përgjithshme të realizuar deri në atë moment nga shoqëria.

Oferta bëhet në përputhje me kuotat e poseduara nga çdo ortak dhe ja bëhet e njohur me shkrim ortakve që janë të regjistruar në librin e ortakve duke lënë një kohë maksimale prej 50 ditësh për të vendosur.

Me të ekaduar ky afat, ortaku shitës ka të drejtën të shesë kuotën të tretve gjithmonë me aprovimin paraprak të Asamblesë së ortakve. Në çdo rast, ortaku shitës ka të drejtë në shoqëri të nënshtrohet miratimit paraprak të asamblesë e cila ka një kohë në die. ozicion prej 30 ditësh për t'u shprehur dhe në rast mospërgjigje brënda këtij afati, miratimi qihet i dhënë.

Kuotat e kapitalit, në rast vdekjeje i kalohen trashëgimtarve duke hyrë këta të fundit në të gjitha të drejtat e ortakut.

NENI 7

Shoqëria është pronare e të disponojë mjetet e saj në përputhje me ligjet shqiptare, të përdorë e të disponojë ato.

NENI 8

Adresa e ortakve përse i përket marrdhënjëve të tyre me shoqërinë është ajo e realizuar në librin e ortakve.

KREU III

ASAMBLEA E ORTAKVE

NENI 9

Asamblea, ligjërisht e thirrur ngjërëjet fax, telex, telegramit

[Signatures]

NEHI 14

Kanë të drejtë të marrin pjesë në Asamblen e ortakëve vetëm ortakët figurorë në librin e ortakëve.

Ortakët mund të përfaqësohen nga një ortak tjetër nëpërmjet një prokure të thjeshtë me sekria.

NEHI 15

Shoqëria administratet nga një administrator i vetëm i zgjedhur për një herë të parë në Aktin e Themelimit të Shoqërisë dhe më pas nga asambleja e ortakëve, i cili është ~~BRITAN DOROLI~~. Administratori i vetëm mund të emëroj administrator të deleguar apo të ngarkuar për veprime të ndryshme dhe përcaktuar edhe fuqitë e tyre.

NRREU IV

BILANCI I SHOQËRISË

NEHI 18

Perjudhat ushtrimore mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo viti të çdo periudhe ushtrimore Administratori i vetëm duhet të përgatisë bilancin sipas afateve e mënyrës së përcaktuar në ligj i shoqëruar edhe me një relacion mbi sigurinë e shoqërisë.

NEHI 19

Fitimi neto që do të rezultojë nga bilanci i shoqërisë do të jetë sipas kapitalit të futur secili dhe ndahet sipas mënyrës së më poshtme:

- 5% do të veqenat për tu përdorur si fond rezervë, përdorimi i pjesës tjetër do tu përkeasi ortakëve me përjashtim të një v. dimi të asambles e ortakv .

Ortakët marrin pjesë në ndarjen e fitimit në propocion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Ortakët mbeten përgjegjës për detyrimet e shoqërisë në propocion me kapitalin e marrë përsipër.

P. s. [Signature]



KREU V

SHËPËRNDARJA DHE LËNDËT

NRINI 20

Aktiviteti i shoqërisë mer fund nga bilancet kontabël kur ajo rezulton se është jo kontabël apo kur ortakët tërhiqen nga shoqëria sipas parashikimit të bërë në aktin e themelimit ose kur mbaron afati i kohë zgjatjes së shoqërisë.

NRINI 21

Duke avritur në shpërndarjen e shoqërisë, Asambleja e ortakëve vendos në përputhje me ligjin, e ërmin e një ose dy li afdat rve duae përcaktuar kompetencat dhe sh ërblimet.

NRINI 22

Çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis ortakëve do të zgjidhet sipas pikës 9 të Aktit të Themelimit.

NRINI 23

Ky akt u redaktua në katër ekzemplarë duke patur të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

DRETTAN DO OLI

RENIS TËRSHANA

Renis

[Handwritten signature and scribbles]

apo me letër rekomandë dhe rregullisht e themeluar përfaqson interesin e ortakëve dhe është organi sovran i shoqërisë. Thirrja duhet të bëhet jo më pak se dhjetë ditë përpara asaj të caktuar për mbledhje.

Vendimet e saj të marra konformë ligjit dhe këtij statuti janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, përfshirë edhe ata në mungesë apo kundër.

NENI 10

Asamblea është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Ajo mbledhet në formën e jashtëzakonshme :

- a/ për të bërë ndryshimet në statutin e shoqërisë.
- b/ për të vendosur rritjen apo uljen në kapitalin e shoqërisë.
- c/ për të kaluar në likuidimin e parakohshëm të shoqërisë ose për të zgjidhur afatin.

NENI 11

Asambletë vendosin në mënyrën të vlefshme me votën pro të shumicës së kapitalit të shoqërisë.

NENI 12

Asambletë thirren nga Administratori i vetëm i precizuar në rendin e ditës dhe argument t që do të trajtohen, në selinë e shoqërisë apo ndonjë vend tjetër, ashtu siç do të përcaktohet në njoftimin e thirrjeve. Asambleja do të jetë rregullisht e mbledhur edhe në mungesë të formiliteteve më lart se herë që të jetë prezent i tërë kapitali i shoqërisë dhe organi administrativ i saj.

NENI 13

Asamblea e zakonshme duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda tre muajve nga myllja e përjdhësve uentrisorë. Asamblea e jashtëzakonshme mbledhet për vendimet e kompetencës së saj sa herë që organi administrativ ta quaj të arsyeshme.

[Handwritten signatures]



AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Sot, më datë 20.X.1995 , këtu në Tiranë u paraqitën personalisht subjektet e mëposhtëms:

1. DRITAN DOKOLI, i biri Hakiut, lindur më 1967 në Tiranë, banor në Tiranë në Rrg. " Tefta Tashko " pll.1 shk.1 ap.14.
2. RENIS TËRSHANA, i biri Agimit, lindur më 1971 në Tiranë , banor në Tiranë.

NENI 1

Midis subjekteve të mësipërm themelohet një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e quajtur " R & T " sh.p.k. IMPORT EXPORT.

NENI 2

Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë në Rrg. " LUIGJ GURAKUQI " Nr. 15 dhe me të drejtë për të ushtruar aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërthëhet në çdo kohë.

NENI 4

Shoqëria ka për objekt të saj:

- Tregtimin e artikujve të ndryshëm, industrial, ushqimor, bujqësor, konfeksione, kinakalerina, mobilje, materjale ndërtimi dhe elektrike me shumicë e pakicë Import - Export.

Si dhe çdo aktivitet tjetër që vë në llogarë ose s'është me ato të përmendura më sipër do të ndikojë në zhvillimin dhe rritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

Jem S

NENI 5

[Signature]

Kapitali i shoqërisë është 100.000lek i ndarë në mënyrë të barabartë.

barabartë në kuota 50% dhe 50% secili merret përsipër dhe nënshkruan si më poshtë:

1. DRITAN DOKOLI 50%
2. RENIS TËRSHANA 50%

Kapitali është i derdhur plotësisht në Bankë .

ENI 6

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator i vetëm. Administratori i shoqërisë do të jetë DRITAN DOKOLI.

ENI 7

Palët kanë një pjesëmarrje në fitimin e shoqërisë në masën e pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e shoqërisë. Palët mbeten gjithashtu përgjegjës për detyrimet e shoqërisë në kufijtë e kapitalit të marrë përsipër.

ENI 8


Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria kur kanë motive të drejta për këtë por duke paralajmëruar shoqërinë dy muaj përpara.

ENI 9

Çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis ortakëve do të zgjidhet miqësisht dhe në mungesë të një marrëveshjeje instanca kompetente do të jetë Gjykata e Tiranës.

PALËT

DRITAN DOKOLI



RENIS TËRSHANA



NR dyp 4045
dt 20/12/1996

12540
dt 23/10/1995

gj/ Flocuo Tegu
dt 11-12-1996
Mull
H

KERKESE

KERKUESI: Shoqeria "R & T" shpk, regjistruar ne Regjistrin Tregtar Nr. 12540 te vendimit, date 23.10.1995, perfaqesuar nga administratori Renis Tershana.

OBJEKTI : Depozitimi i vendimeve te asamblese dhe dokumentave te tjera te ndryshimeve ne statutin e shoqerise "R & T" shpk.
Baza ligjore ligji 7667, date 25.1.1993.

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Z. Kryetar,

Shoqeria "R & T" shpk eshte themeluar dhe regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Gjykates Rrethit Tirane me vendim nr. 12540, date 23.10.1995.

Me date 15 gusht 1996 Asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka mbajtur nje mbledhje ku ka marre edhe vendimet perkatese per:

1) Transferimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga ortaku Dritan Dakoli ne favor te ortakut tjeter Renis Tershana, i cili mbas ketij transferimi mbetet ortak i vetem i shoqerise "R & T" shpk duke zoteruar 100% te pjeseve te kapitalit te saj, transferim qe eshte bere me ane te kontrates se shitjes nenshkruar para noteres;

2) Emerimin e Z.Renis Tershana, i biri Agimit, lindur ne Tirane me date 23/09/1971, banues ne Tirane, Rruga "Shyqyri Ishmi", Nr. 17, ne detyren e administratorit te vetem te shoqerise "R & T" shpk, mbas doreheqjes se ish administratorit Dritan Dakoli nga kjo detyre.


Ne baze te ketyre ndryshimeve asambleja ka vendosur edhe per ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise "R & T" shpk.

Ne keto kushte ne mbeshtetje te dispozitave te ligjit 7667, date 28.01.1993 kerkojme depozitim ne aneksin e regjistrin tregtar te proces verbalit te vendimeve te Asamblese se ortakeve date 15 gusht 1996, te kesaj shoqerie duke pasqyruar edhe ndryshimet perkatese.

Bashkelidhur ju dergojme nga nje kopje te proces-verbalit te Asamblese se Ortakeve, date 15 gusht 1996 si dhe kontraten e shitjes (transferimit) te pjeseve te kapitalit.

Tirane, date 10/12/1996

ADMINISTRATORI
(Renis Tershana)



RENIS TERSHANA,

20. 12. 1996

Te depozituar
dt 20. 12. 1996
Mull
H

**PROCES VERBAL
I ASAMBLESE SE ORTAKËVE
DATE 15 GUSHT 1996**

Ne vitin njemije e nenteqin e nentedhjet e gjashte
dhe ne 15 Gusht, ne oren 10.00 para dite

Ortakët e shoqërisë "R & T" sh.p.k., një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, me një kapital themeltar prej 100.000 leke, zyra e regjistruar e të ciles ndodhet në Tiranë, Rruga "Luigj Gurakuqi", Nr.15, mbajti një mbledhje të përgjithëshme të jashtëzakonëshme, në zyrat e regjistruara të saj, sipas lajmerimit të bere nga Administratori i saj, me qëllim që të shqyrtohet rendi i dities si me poshte:

- 1) Miratimi i transferimit të pjeseve të kapitalit të ortakut Dritan Dakoli dhe largimit të tij nga shoqëria;
- 2) Miratimi i dorëheqjes së Administratorit të Vetem;
- 3) Emerimi i administratorit të ri;
- 4) Ndryshimet në Statutin e shoqërisë.

MOREN PJESE NE MBLEDHJE

- Ortaku Dritan Dakoli, zoterues i 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku Renis Teršana, zoterues i 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Mbledhja kryesohet nga Administratori i Vetem Dritan Dakoli. Ortakët emerojnë sekreter të mbledhjes Renis Tershanen.

